



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 296, Datë 18.11.2022

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 93, DATË 28.04.2022
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ECO - ELB” SH.A. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË
MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 KW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1948/1 prot., datë 10.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 28.04.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “ECO - ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali prodhues i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW, deri në datën 27.03.2023. Brenda datës 01.07.2022 shoqëria duhet të depozitonte në ERE dokumentet/qëndrimin përkatës të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në lidhje me transferimin e lejeve.
- Me shkresën nr. 560/5 prot., datë 05.05.2022, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr.93/2022.
- Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 93/2022, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 560/6 prot., datë 23.06.2022, shoqëria ka bërë me dije se në vijim të kërkesës së saj të depozituar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 177, datë 06.06.2022, ka përfunduar transferimi i lejes mjedisore të tipit A, me PN-5783-09-2017.
- Po ashtu, ka bërë me dije se përsa i përket transferimit të lejes mjedisore të tipit A “Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte”, ka pasur komunikime të vazhdueshme me AKM-në dhe kjo leje është në proces transferimi.

- Në vijim, ERE i është drejtuar AKM-së me shkresën nr. 560/8 prot., datë 28.07.2022 dhe nëpërmjet postës elektronike e-mailin e datës 14.09.2022 dhe shkresën nr. 560/11 prot., datë 18.10.2022, duke kërkuar informacionin/sqarimin përkatës nëse kjo leje lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti “ECO-ELB” sh.a., apo ushtrimi i veprimtarisë përkatëse për të cilën është dhënë kjo leje është i ndarë nga veprimtaria e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 27.10.2022, AKM ka informuar ERE-n se leja e mjedisit të tipit A, e subjektit “ECO-ELB” sh.a., për veprimtarinë “Lendfilli i mbetjeve (D1), duke përjashtuar lendfillimin e mbetjeve inerte, është e ndarë nga veprimtaria e prodhimit të energjisë elektrike.
- Për sa më sipër, pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 93, datë 26.04.2022, duhet të shfuqizohen.
- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2022, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI